POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 'Dy gosti', filmi me lejlekun punëtor do të restaurohet

2 Albulena Haxhiu mandaton Albin Kurtin për formimin e Qeverisë së re të Kosovës

3 Kriza e pagave, Rama-gjyqtarëve: Respektojmë vendimin e Kushtetueses, por pa kërcënime! Bëhen më të mirëpaguarit në Ballkan! (VIDEO)

4 Kremlini: Po përgatiten bisedime të reja trepalëshe me SHBA-në dhe Ukrainën në tetor

5 Nuk ka 'fund' droga e sekuestruar e 'të tmerrshmit të Beratit', gjenden edhe 27 kg kokainë pranë vendit ku u arrestua Lulzim Caka

Kronikë

# Shpërthim me tritol në qendër të Shkodrës, lënda plasëse e vendosur në oborrin e banesës së një 60-vjeçari (EMRI+VIDEO)

*Shpërthimi ka shkaktuar dëme të shumta materiale, jo vetëm në banesën ku ishte vendosur, por edhe në pallatet përreth, xhamat e të cilëve janë thyer. Fatmirësisht nuk ka pasur persona të lënduar.*

Shpërthim me tritol në qendër të Shkodrës, lënda plasëse e vendosur
Report TV

Watch on

Redaksia
12 Shtator, 22:13 | **Përditesimi: 12 Shtator, 22:53**

Share | Post

Një shpërthim me lëndë plasëse (tritol) ka ndodhur mbrëmjen e sotme në lagjen "Qemal Stafa" në Shkodër.

Burime për Report Tv bëjnë me dije se lënda plasëse është vendosur në oborrin e një banese në qendër të qytetit, prapa Bashkisë së Shkodrës, e cila është në pronësi të një 60-vjeçari, shtetasit Metin Bushati.

Fatmirësisht nga shpërthimi nuk ka pasur persona të lënduar, por vetëm dëme materiale. Në pallatet që ndodhen pranë vendit të ngjarjes, janë thyer disa xhama.



LEXO EDHE:
**Një nga ne/ Këpucari Dritan Ceni rrëfen realitetin e trishtë: Në Shkodër i riparojnë disa herë këpucët, s'kanë mundësi ekonomike**

Forca të shumta Policie kanë rrethuar vendin e ngjarjes dhe po hetojnë për identifikimin dhe kapjen e autorit/autorëve të dyshuar, si dhe për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes.

Pista kryesore e hetimit nga ana e Policisë është një konflikt i mundshëm që mund të jetë përfshirë i vllai i 60-vjeçarit, shtetasi Gëzim Bushati, i cili jeton prej vitesh në Gjermani dhe është me precedent penal.

> ***Njoftimi i Policisë:***
>
> *Shkodër / Informacion paraprak- Rreth orës 21:30, në lagjen "Qemal Stafa", Shkodër, në oborrin e banesës së shtetasit M. B., rreth 60 vjeç, nga persona ende të paidentifikuar është hedhur një sasi e vogël lënde plasëse, duke shkaktuar vetëm dëme të vogla materiale.*
>
> *Grupi hetimor, nën drejtimin e Prokurorisë, vijon punën për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes, si dhe për identifikimin dhe kapjen e autorit/autorëve.*

R.Xh/Shqiptarja.com

TAG: Shkoder | shperthim | shperthim me tritol | bashkia shkoder | dëme materiale | Metin Bushati

Sa e vlerësoni këtë artikull? 3.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

## Komente

Komento

**Alb:** 13/09/2026 01:10
Shkodra ka maru
Përgjigju

**Bla:** 13/09/2026 08:45
Të vijë flamingot pëtë na shpëtuar haaaa

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:** 7 Shtator, 07:56
**Ngërçi për pagat e drejtësisë, kujt i jepni të drejtë?**

Qeverisë | Magjistratëve | Nuk e di




## Lajme të tjera



Rrjoll, rikthehen protestat kundër resortit të Bashkim Ulajt! Banorët përplasen me policinë: Nuk e falim tokën, stop ndërtimit
Ergys Kavaja
12 Shtator, 13:52



Transportonte 11 emigrantë drejt Shkodrës për t'i kaluar në Mal të Zi, arrestohet 27-vjeçari! Në kërkim dy bashkëpunëtorët
11 Shtator, 13:15



'Pse më sheh', vrau bashkëmoshatarin në derën e shtëpisë, Gjykata e Shkodrës lë në burg autorin!
11 Shtator, 12:00



Pas 30 vitesh pritje, nis asfaltimi i rrugës në Domën! Fshati panoramik i Shkodrës pret t'i rikthehet zhvillimit
10 Shtator, 17:35



Kthehet në tragjedi shpërthimi që plagosi 6 anëtarët e familjes Kola në Lezhë, kryefamiljari humb jetën pas 12 ditëve
Elvis Hila
10 Shtator, 15:53



Shkodër/ Kërcënuan me kallash e pistoletë dy persona pas sherrit me një të mitur, 2 në kërkim
10 Shtator, 12:35



7 vatra aktive zjarri në të gjithë vendin, 10 nën monitorim! Riaktivizohen flakët në Mallakastër, ndërhyhet me helikopter
10 Shtator, 10:29



Shpërthimi te karburanti 'Eida'/ Ende i paqartë shkaku, 3 punonjësit: Po furnizonim një makinë me gaz, nuk e kuptuam si ndodhi
Sokol Dema
10 Shtator, 10:18



Shpërthimi me 3 të plagosur te 'Eida' në Tiranë, eksperti Mehmeti: Pikat e karburanteve duhet të ndërtohen larg qendrave të banuara, shkollave e kopshteve!
9 Shtator, 18:29



'Lëvizja e parë antikomuniste', PD përkujton 80-vjetorin e Kryengritjes së Postribës! Berisha: Dëshmi se liria nuk shuhet me terror
9 Shtator, 16:47



Shpërthim gazi te karburant 'Eida' në Tiranë, plagosen 3 punonjës! Dy versione për shkakun, Zjarrfikësja: Dyshohet se erdhi nga zyra! ISHTI: Flakët nisën nga një makinë! 3 të shoqëruar
Sokol Dema
9 Shtator, 07:24



Helmimi në Fushë Arrëz, Report Tv siguron raportin e ISHP-së: Erdhi nga uji i pijshëm
Armir Mehaj
8 Shtator, 08:58

Lajmi i fundit



'Dy gosti', filmi me lejlekun punëtor do të restaurohet
13 Shtator, 13:43



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Lajmi i fundit



‘Dy gosti’, filmi me lejlekun punëtor do të restaurohet

13 Shtator, 13:43